

Nr. 2304/31 K (e-k) Prot.
Tiranë, më datë 20/04/2023

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
z. Ilirjan CELIBASHI
N/Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,
zj. Lealba PELINKU
Anëtarëve të Komisionit Rregullator
Anëtarëve të Komisionit të Ankimimeve
dhe Sanksioneve

Për dijeni: Këshillit të Lartë Gjyqësor
Kryetares znj. Naureda LLAGAMI
Subjekteve Zgjedhore të regjistruara për
Zgjedhjet Vendore të 14 majit 2023
Misionit të OSBE/ODIHR në Shqipëri
Trupit Diplomatik dhe Organizatave
Ndërkombëtare me seli në Tiranë

Lënda: KËRKESË – Për adresimin e
problematikave që lindin nga ndryshimi
i Qendrave të Votimit për një të tretën e
zgjedhësve.

Të nderuar Anëtarë të Organeve Drejtuese të KQZ-së!

Të nderuar Kolegë të Administratës së KQZ-së!

Në vazhden e monitorimit të procesit për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të 14 majit 2023, KRIIK ka marrë dijeni, nëpërmjet raporteve të auditëve teknikienë dhe takimeve me zyrtarë të DPGJC dhe të Ministrisë së Brendshme se rreth 1.28 milionë zgjedhësve (përafërsisht 35% e tyre) iu është ndërruar qendra e votimit nga ekstrakti i dytë në listën përfundimtare të zgjedhësve.

Kjo gjë mund të sjellë jo vetëm konfuzion tek zgjedhësit apo vështirësi për të votuar në ditën e zgjedhjeve, por edhe mundet që ta bëjë praktikisht të pamundur ushtrimin e së drejtës së votës prej tyre.

Na lejoni të sjellim në vëmendjen tuaj se sigurimi i së drejtës së qytetarit për të votuar aty ku ka vendbanimin, si dhe lehtësimi i procesit të korigjimit të përbërësve zgjedhorë pas shpalljes së listës finale të zgjedhësve, është jo vetëm një detyrim ligjor, por edhe një e drejtë thelbësore që shteti duhet t'i sigurojë qytetarit, të drejtën për të votuar.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Në frymën e sa më sipër, **KRIIK Ju drejtohet me këtë Kërkesë, mbi disa hapa që, në gjykimin tonë, KQZ-ja, si Institucioni më i lartë që ka nën përgjegjësi garantimin e një procesi zgjedhor brenda standardeve, mund të ndërmarrë për të adresuar këtë çështje.**

Kujtojmë gjithashtu se KQZ-ja është institucioni i ngarkuar nga ligji për mbikqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve (neni 50 dhe 61 i Kodit Zgjedhor).

Së pari, në gjykimin e KRIIK, **nevojitet sa më parë një sqarim i plotë për publikun** në lidhje me këtë çështje nga ana e KQZ-së, dhe konkretisht nga ana e Komisionerit, duke qenë se kjo çështje nuk është trajtuar në mënyrë publike në asnjë rast, madje as shqyrtimi i gjetjeve të raporteve të auditëve teknikienë.

Ky sqarim do të ishte e udhës të përmbante detaje në lidhje me arsyet dhe mënyrën se si ky ndryshim në adresat e qendrave të votimit ku ata do të votojnë është bërë, sikurse edhe mund të jepet një informacion i përditësuar në lidhje me numrin e qytetarëve që janë drejtuar nëpër KZAZ për të kërkuar informacion mbi QV-në ku do të votojnë.

Në gjykimin e KRIIK, informacioni në lidhje me pikën e parë do të ishte e udhës të ofrohej në mënyra proaktive nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ku edhe janë kryer ndryshimet, por, në çdo rast, gjykohet se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, si zyrtari më i lartë shtetëror për përgatitjen e zgjedhjeve, duhet ta kërkojë këtë informacion nga DPGJC-ja dhe ta bëjë me dije për publikun, në emër të transparencës.

Theksohet se në historikun e zgjedhjeve të deritanishme, është hera e parë kur bëhet ndryshim i Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm në mes të procesit të hartimit të listave, duke sjellë si rrjedhojë zhvendosjen e qendrës së votimit për 1,28 milionë zgjedhës.

Së dyti, KRIIK gjykon se, në këto rrethana, **fushata e informimit për qytetarët** që KQZ ka ndërmarrë nëpërmjet spoteve, posterave, etj., do të duhet të jetë shumë më intensive dhe **e fokusuar në veçanti në informimin e qytetarëve për të kontrolluar** sa më parë emrin e tyre në listë, si dhe qendrën e votimit ku janë parashikuar të votojnë.

Së treti, Kodi Zgjedhor në nenin 57 “Vendimet gjyqësore pas hartimit të listës së zgjedhësve” përcakton se:

“1. Kur zgjedhësi vëren se përbërësi i tij zgjedhor përmban pasaktësi, nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit të vendbanimit të tij ose nuk është regjistruar fare në ndonjë nga listat e njësisë së qeverisjes vendore ku ai ka vendbanimin, ai ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës deri 24 orë përpara datës së zgjedhjeve. Kërkesa, sipas kësaj pike, përjashtohet nga taksat gjyqësore. ...

3. Gjykatat e rretheve gjyqësore shqyrtojnë dhe vendosin në lidhje me kërkesat, sipas pikës 1 të këtij neni, si në ditën e fundit para zgjedhjeve, edhe në ditën e zgjedhjeve, por jo më vonë se 6 orë përpara mbylljes së votimit. Në rastin kur vendimi gjyqësor bën korrigjimin e përbërësve zgjedhorë, përcaktohet qartë përbërësi zgjedhor që ndryshohet. Kur saktësohet qendra e votimit ose zgjedhësi shtohet në listë, vendimi gjyqësor përcakton qendrën e votimit ku zgjedhësi do të votojë dhe numrin e dokumentit të identifikimit. ...”.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Ky mekanizëm njihet tashmë si mundësi nga qytetarët, megjithëse pranohet se në zgjedhjet e mëparshme numri i zgjedhësve që kanë votuar me vendim gjyqësor nuk ka qenë i konsiderueshëm.

Ashtu sikurse pranohet se ka patur raste që zgjedhës, të cilët nuk kishin një Gjykatë të Rrethit Gjyqësor pranë vendbanimit të tyre, nuk e kanë shfrytëzuar këtë mekanizëm, të fundit në dispozicion, duke ngelur pa votuar.

Aktualisht në këto zgjedhje, për shkak të situatës së lartpërmendur, me gjasë numri i qytetarëve që mund të kërkojnë të votojnë me vendim gjykate mund të jetë më i lartë.

Ndërkohë, me aplikimin e hartës së re gjyqësore që hyn në fuqi më datën 1 maj 2023, qasja e qytetarëve në gjykata do të jetë më e vështirë, duke qenë se disa prej gjykatave do të shkrihen.

Lidhur me gjithë sa më sipër, KRIIK zhvilloi një takim më datë 13 mars 2023 me përfaqësues të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) ku parashtrori shqetësimin e mësipërm dhe diskutoi për mënyrat e adresimit të çështjes.

Më datën 14 prill 2023, KRIIK i dërgoi një Kërkesë zyrtare KLGJ-së ku i kërkonte **të ndërmarrë hapat e nevojshëm proceduralë e institucionalë**, duke siguruar që Gjykatat e Shkallës së Parë në të gjithë vendin të jenë të vëmendshme ndaj kësaj situate dhe **të marrin masat e duhura për të trajtuar me prioritet dhe në kohën më të shkurtër kërkesat e qytetarëve që kërkojnë të votojnë me vendim gjykate** (gjeni bashkëlidhur shkresën zyrtare të nisur).

Pavarësisht angazhimit të KLGJ-së në këtë çështje, nëse do të ketë një të tillë nga ana e këtij Institucioni, KRIIK vlerëson se **angazhimi i KQZ-së është shumë i rëndësishëm për adresimin konkret dhe të menjëhershëm të problematikës**.

KRIIK i ka parashtruar disa kërkesa konkrete KLGJ-së që në opinionin e tij vlejnë të merren në konsideratë (*lutemi referojuni shkresës bashkëlidhur*), por e **gjykon të domosdoshëm ndërveprimin dhe koordinimin e menjëhershëm të KQZ-së me të**, me qëllim krijimin e lehtësive të nevojshme për të siguruar aksesin në gjykatë të qytetarëve e mundësuar respektimin e së drejtës së tyre për të votuar.

Në përfundim sillet në vëmendje se, në çdo rast, Kushtetuata dhe ligji parashikojnë detyrimin e shtetit shqiptar dhe institucioneve të tij që t'i sigurojnë të drejtën e ushtrimit të votës çdo zgjedhësi, ndaj në këtë pikëpamje, **kjo e drejtë nuk mund t'i mohohet për asnjë shkak qoftë edhe një qytetari të vetëm**.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,

Me konsideratë,

**Për Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto Gogo
Kryetar**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania